



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AD/GJKK/1/23

Kryetari i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Mahir Tutuli, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga M.Sh., për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares V.P.R. bazuar në dispozitën e Nenit 9, paragrafit 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafit 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 21.03.2023 merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga M.Sh. ndaj gjyqtares V.P.R. për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

M.Sh. në cilësi të palës së dëmtuar me datë 02.03.2023 përmes parashtrësës dërguar Autoritetit Kompetent të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka ushtruar ankesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares V.P.R..

Gjykata Themelore në Prishtinë me aktin përcjellës të datës 06.03.2023 i është drejtuar Kryetarit të Gjykatës Komerciale se në rastin konkret në bazë të Nenit 9, paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve kur ankesa i drejtohet Autoritetit Jo Kompetent, Autoriteti i tillë do të transferojë ankesën tek Autoriteti Kompetent duke e njoftuar dërguesin për këtë.

Parashtruesi i ankesës M.Sh. në cilësi të palës së dëmtuar ka paraqitur ankesë ndaj gjyqtares V.P.R. për shkak të pretendimeve se, gjyqtarja ka qenë e njëanshme dhe është munduar ta përjashtoj të dëmtuarin M.Sh. nga seancat dhe në dy seanca nuk e ka ftuar fare M..., kurse në seancën e datës 28.02.2022 pala ankuese ka deklaruar se e ka pyetur gjyqtaren se pse nuk e ka ftuar në seancë si palë e dëmtuar, gjyqtarja i është përgjigjur se "adresa ka qenë gabim". Ka deklaruar se gjyqtarja gjatë seancës nuk e ka lejuar që ta dorëzoj asnjë provë kinse seanca është fillestare. Ka pretenduar se gjithashtu nuk i është dhënë procesverbali i nënshkruar mirëpo vetëm një procesverbal i panëshkruar duke i propozuar Autoritetit Kompetent që të ndërmarr masa të nevojshme në raport me shkeljet etike të gjyqtares së rastit.

Në lidhje me pretendimet e parashtruesit të ankesës, gjyqtarja V.P.R. ka deklaruar se, se ne rastin konkret pasi lënda është transferuar në zyrën e saj, brenda mundësive objektive i ka ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura procedurale për ta proceduar rastin.

Ka shtuar se sipas listave që i posedon në shënimet e saj, lënda me numër P.nr .../2017 është pranuar me datë 14.09.2020 nga lëndët e bartura të gjyqtarit K.Sh. Me këtë datë (në të njëjtën listë) fillimisht janë të pranuar gjithsej 800 lëndë (të bartura nga disa gjyqtar), të viteve të ndryshme duke filluar nga viti 2012 e tutje. Me rastin e pranimit janë kontrolluar të gjitha lëndët dhe ka pasur edhe lëndë të parashkuara dhe para parashkrimit - çoftë relativ apo absolut. Për këtë lëndë është konstatuar se nuk është ndërmarrë asnjë veprim procedural. Të gjitha lëndët janë trajtuar sipas radhës dhe prioritetit ligjor brenda mundësive objektive, në mungesë të kushteve adekuate, në mungesë të zyrtarëve profesional dhe duke pas parasysh edhe mbingarkesën me rreth 1800 lëndë aktive.

Ka theksuar se nuk i kujtohet data e saktë se kur janë ndërmarrë veprimet e para procedurale në këtë lëndë. Por, sipas përgjigjes së Gjykatës në shkresën e datës 15.02.2023 (te bashkangjitur ne emailin e pranuar) thuhet se procedura është veçuar në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 18.11.2021, ndaj dy të pandehurve A.SH. dhe B.SH. ndaj të cilëve është lëshuar Urdhër arrest. Sigurisht, këtyre veprimeve procedurale ju kanë paraprirë veprime të tjera, e të cilat rrjedhimisht kanë diktuar marrjen e veprimeve procedurale të veçimit të procedurës dhe lëshimit të urdhër arrestit. Prandaj me siguri veprimet paraprake procedurale për caktimin e seancës së shqyrtimit fillestar dhe sigurimit të prezencës së të pandehurve janë ndërmarrë kohë më parë - para datës 18.11.2021. Dhe vetëm pas plotësimit të kushteve ligjore për shkak të pamundësisë së sigurimit të prezencës për dy të pandehurit janë ndërmarrë këto veprime. Sipas të dhënave rezulton se me datë 24.03.2022 është parashtruar kërkesa për hudhjen e aktakuzës, të cilën për shkak të angazhimit në seanca të tjera nuk ka arritur ta shqyrtoj, e poashtu gjatë kësaj periudhe kam pasur edhe orarin e kujdestarisë (nga 2-8 Maj). Në Departamentin Themelore Divizionin Penal - java e kujdestarisë dhe java vijuese është një periudhë mjaft e ngarkuar me numër të lartë të kërkesave urgjente. Më pas me datë 23.06.2022 është emëruar gjyqtare në Gjykatën Komerciale dhe nuk ka pasur me kompetence të procedoj me rastet penale.

Në fund ka deklaruar se pretendimet e palës së dëmtuar për zvarritje të qëllimshme të procedurës dhe përfshirjen e saj në këtë me qëllim për ta dëmtuar palën e dëmtuar janë të pabazuara. Të gjitha veprimet e ndërmarra janë të dokumentuara në shkresat e lëndës. Transferimi i lëndës tek gjyqtari tjetër është bërë për arsye të tjera dhe është e pamundur të bëhet transferimi me qëllim të ikjes së përgjegjësisë.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Komerciale të Kosovës, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarës dhe pretendimeve të parashtruesit së ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarës V.P.R..

Nga faktet e çështjes rezulton se, nuk ka bazë të arsyeshme për inicimin e hetimeve për shkelje disiplinore në veprimet e gjyqtarës V.P.R. lidhur me njëanshmërinë dhe për zvarritje të qëllimshme të procedurës, për të cilat parashtruesi është ankuar.

Nga pretendimet e palës ankuese rrjedh se shkeljet e pretenduara disiplinore konsistojnë në: njëanshmëri të gjyqtarës dhe për zvarritje të qëllimshme të procedurës.

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Komerciale të Kosovës vlerëson se në rastin konkret pas shqyrtimit të dosjes dhe shkresave të lëndës nuk ka arritur të provojë pretendimet e palës ankuese për njëanshmërinë dhe për zvarritje të qëllimshme të procedurës të cilat janë objekt i kësaj ankese disiplinore, për më tepër nga procesverbali i seancës gjyqësore të datës 28.02.2022 rezulton se procesverbali është nënshkruar pa vërejte nga palët - gjë që paraqet provë të vetme e cila është shqyrtuar në këtë çështje disiplinore.

Autoriteti i kësaj gjykate, bazuar në shkresat e lëndës ka gjetur se gjyqtarja e rastit i ka respektuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale lidhur mbarëvajtjen e procedurës në shqyrtim gjyqësor, ashtu që fillimisht procedura është veçuar në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 18.11.2021, ndaj dy të pandehurve A.SH. dhe B.SH. ndaj të cilëve është lëshuar urdhër arrest dhe se veprimet paraprake procedurale për caktimin e seancës së shqyrtimit fillestar dhe sigurimit të prezencës së të pandehurve janë ndërmarrë - para datës 18.11.2021. Nga shkresat e lëndës rezulton se me datë 24.03.2022 është parashtruar kërkesa për hudhjen e aktakuzës, ndërsa në seancën e fundit të datës 28.02.2022 e cila seancë sipas shkresave të lëndës është mbajtur dhe palët nuk kanë pasur vërejtje në punën e gjyqtarës, dhe për këtë Autoriteti i kësaj gjykate vlerëson se nuk është shkelur dispozita e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Pretendimet e palës së dëmtuar për zvarritje të qëllimshme të procedurës dhe përfshirjen e gjyqtarës me qëllim për ta dëmtuar palën e dëmtuar janë të pabazuara dhe të njëjtat përbëjnë pretendime për shkelje procedurale të cilat mund të atakohen në procedura gjyqësore por nuk përbëjnë shkelje disiplinore, të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Komerciale të Kosovës lidhur me ankesën e ushtruar. bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme se gjyqtarja ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore. Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
AD/GJKK/1/23, me datë 21.03.2023

Mahir Tutuli

Kryetar i Gjykatës Komerciale